



Pyetje dhe Përgjigje të Kombinuara
për Thirrjen Publike për Projekt-Propozime për Organizatat Jofitimprurëse
"Recraft the Past: Build Up the Future 3"
(CFP 05-2024)

Ky dokument shërben si regjistër i sqarimeve të dhëna palëve të interesuara në lidhje me Thirrjen e Hapur për Projekt-Propozime për Organizatat Jofitimprurëse "Recraft the Past: Build Up the Future 3" (CFP 05-2024) në përgjigje të kërkesave të tyre të marra brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave. Pyetjet u pranuan përmes kanaleve të ndryshme të përcaktuara në Udhëzimet e kësaj Thirrje, duke përfshirë ato verbale gjatë sesioneve informuese të EU4Culture në lidhje me Thirrjen, përmes emaileve me shkrim, si dhe gjatë takimeve dhe telefonatave. Përgjigjet e pyetjeve të marra janë përmbledhur në këtë dokument.

Q: Cila është përqindja e lejuar e buxhetit për kostot e burimeve njerëzore dhe kostot administrative në këtë thirrje?

A: Të gjitha pragjet e buxhetit janë shënuar në **Seksionin 2.5.2 [Budget Thresholds]** të Thirrjes për **Projekt-Propozime**. "Shpenzimet e përgjithshme të personelit kushtuar ekipit të projektit (siç përshkruhet dhe përfshihet në kategoritë buxhetore - Personeli) nuk duhet të kalojnë 25% të buxhetit total". Kostot operative (të tilla si shpenzimet ditore të karburantit dhe transportit, telefoni fiks/celular, energjia elektrike, faturat e ujit, etj) nuk janë kosto të pranueshme sipas **Seksionit 2.5.3 [Ineligible Costs]** të Thirrjes për Projekt-Propozime.

Q: A mund të specifikoni përqindjen e lejuar për cdo kategori buxhetore në këtë Thirrje?

A: Kategoritë e buxhetit që kanë pragje janë shënuar në **Seksionin 2.5.2 [Budget Thresholds]** të Thirrjes për Projekt-Propozime.

Q: Cilat janë përparësitë për ndërhyrje në cdo fushë në këtë Thirrje?

A: Kjo Thirrje për Projekt-Propozime ka dy tema kryesore dhe gjashtë ndërsektoriale për të gjitha fushat e synuara. Temat janë përshkruar në **Seksionin 1.4 [Scope of the Grant/Funding]** të Thirrjes për Projekt-Propozime.

Q: Cilat janë kriteret kryesore që kërkoni për një propozim të suksesshëm?





A: Kriteret që do të përdoren për vlerësimin e propozimeve janë shënuar në **Seksionin 3.2 [Technical Evaluation]** dhe **3.3 [Financial Evaluation]** të Thirrjes për Projekt- Propozime.

Q: A është parashikuar të ketë burime ose mbështetje për të ndihmuar organizatat në përgatitjen e propozimeve të tyre për këtë Thirrje?

A: Kjo Thirrje për Projekt-Propozime ofron mundësinë e mbështetjes së aplikantëve të mundshëm përmes dy sesioneve informuese me prani fizike dhe përgjigjeve me shkrim për kërkesat për sqarime.

Q: A do të ketë ndonjë sesion informues ose seminar për të dhënë udhëzime mbi procesin e aplikimit?

A: Kjo Thirrje për Projekt-Propozime ofron mundësinë për dy sesione informuese me prani fizike siç është cekur në **Seksionin 1.18 [Important Dates and Deadlines]** të dokumentit të Thirrjes për Projekt-Propozime.

Q: A pritët që Shtojca A të dorëzohet në PDF apo në formate të tjera pasi ka disa vende ku kërkohen nënshkrime?

A: Siç vërehet në Udhëzuesin e Thirrjes për Projekt-Propozime, Shtojca A duhet të dorëzohet si në versionin Word ashtu edhe në PDF. Ky i fundit duhet të nënshkruhet dhe vuloset në seksionet përkatëse të treguara brenda modelit.

Q: A pritët që letrat e referencës të jenë nga donatorë që kanë financuar projekte të mëparshme brenda fushave që lidhen me këtë Thirrje për Projekt-Propozime?

A: Referencat duhet të lëshohen nga burime financimi të cilat kanë financuar projekte të zbatuara nga aplikanti brenda 5 viteve të fundit. Sigurimi i letrave të referencës që tregojnë një fushë veprimtarie në lidhje me këtë Thirrje mund të rrisë shanset që propozimi të marrë rezultate më të larta gjatë procesit të vlerësimit. Megjithatë, përshkrimi i një fushe përkatëse të aktivitetit në letrën e referencës nuk është kërkesë e detyrueshme e pranueshmërisë.

Q: Ne jemi një organizatë që jemi tërhequr nga një projekt i mëparshëm. A kemi të drejtë të aplikojmë në këtë Thirrje?

A: Nuk është e qartë nëse tërheqja ishte nga një thirrje e mëparshme e UNOPS-it *Recraft the Past, Build up the Future*, apo nga një Thirrje tjetër jo e UNOPS-it ose e UNOPS-it por pa lidhje me këtë Thirrje, dhe nëse ka ndodhur para kontraktimit apo gjatë zbatimit. Nëse tërheqja nuk është kërkuar nga UNOPS-i,





apo nga një agjenci tjetër e OKB-së, ose nga ndonjë ent tjetër për arsye që lidhen drejtpërdrejt me hetimet për mashtrim financiar apo për Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual, organizata ka ende të drejtë të aplikojë *për këtë thirrje Recraft the Past, Build up the Future 3.*

Q: Në rast se propozimi do të përfshijë artizanët, a mundet organizata të parashikojë në buxhetin e projektit përfshirjen e artizanëve me kontrata pune që përfshijnë kosto të tilla si tarifën e sigurimeve shoqërore dhe detyrime të tjera të ngjashme?

A: Nëse projekt-propozimi do të angazhonte artizanë si punonjës me kohë të plotë ose të pjesshme në përputhje me legjislacionin kombëtar të punës, organizata do të duhet të përdorë kategorinë e buxhetit "Personeli". Duke vepruar kështu, aplikanti do të duhet të demonstrojë qartë nevojën për një angazhim të tillë për të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të kohëzgjatjes së projektit. Megjithatë, siç tregohet në modelin e buxhetit, kontratat e "personelit" zakonisht përdoren për funksione thelbësore që përfshijnë koordinimin e menaxhimit dhe mbështetjen financiare. Sidoqoftë, zgjedhja për të përfshirë artizanët si "Personel" mund të varet nga arsye të tjera specifike të projektit në përputhje me konceptin e tij.

Q: A mundet një organizatë që nuk ka përvojë në këtë fushë (që lidhet me këtë Thirrje) të aplikojë për këtë Thirrje duke punësuar ekspertë ose profesionistë të tjerë në këtë fushë?

A: Nuk është një kërkesë e detyrueshme që aplikanti(ët) të kenë ekspertizë ose përvojë në fushën e veprimtarisë së parashikuar në këtë Thirrje. Megjithatë, përvoja dhe ekspertiza përkatëse e aplikantit(ëve), nëse dhe kur demonstron qartë, mund të ndikojë pozitivisht në vlerësimin e projekt-propozimit. Ndërkohë që rëndësia e ekspertizës dhe përvoja e aplikantit(ëve) vlerësohet kundrejt kriterëve specifike të vlerësimit, rëndësia e përvojës dhe përvojës së ekspertit(ëve) të përfshirë në propozim vlerësohet gjithashtu kundrejt një grupi të veçantë kriteresh vlerësimi. Kriteret e vlerësimit dhe pikët përkatëse publikohen si pjesë e dokumentit të Thirrjes për Projekt-Propozime.

Q: Sa është përqindja maksimale e buxhetit për stafin dhe ekspertët në këtë thirrje?

A: Kostot buxhetore për "personelin" dhe për "ekspertët" nuk duhet të kalojnë respektivisht 25% dhe 20%.

Q: Nëse një nga ekspertët që kemi përfshirë në formularin e aplikimit vendos të tërhiqet nga zbatimi, çfarë duhet të bëj?

A: Sipas seksionit të kushtuar në **Shtojcën A - [Proposal]**, ekspertët kryesorë të listuar në projekt-propozim duhet të deklarojnë dhe nënshkruajnë disponueshmërinë e tyre për angazhim brenda afatit kohor të specifikuar dhe brenda të njëjtit projekt. Ky seksion duhet të lexohet, kuptohet dhe





nënshkruhet nga të gjithë ekspertët e identifikuar në fazën e shkrimit të propozimit. Problemet që mund të dalin gjatë zbatimit të projektit, në rast se propozimi do të pranohet për kontraktim, do të rregullohen sipas kërkesave operacionale për zbatimin e kësaj Thirrjeje, të cilat do të ndahen me partnerët e mundshëm zbatues në një fazë të mëvonshme.

Q: Nëse organizimi i një eventi është planifikuar si aktivitet në kuadër të projekt-propozimit, si mund të kategorizohen ekspertët e parashikuar për atë event?

A: Nëse ekspertët parashikohen të angazhohen në aktivitetet e projektit të propozimit, ata duhet të përfshihen në kreun e buxhetit “Konsulentët/Ekspertët”.

Q: A mund të marrë pjesë një individ si ekspert në një projekt propozim nëse organizata partnere është nga Kosova?

A: Të gjitha organizatat partnere duhet të jenë të regjistruara në Shqipëri sipas ligjit shqiptar. Organizatat partnere të regjistruara jashtë Shqipërisë mund të përfshihen në projekt propozim si partnerë të asociuar.

Q: A mund të jenë partnerë në projekt-propozim bizneset e mëdha në zonat e përzgjedhura për këtë Thirrje?

A: Subjektet fitimprurëse nuk mund të përfshihen si partnerë në projekt propozimet që do të vlerësohen në kuadër të kësaj Thirrjeje. Megjithatë, ata mund të përfshihen si partnerë të asociuar. Informacione më të detajuara për partnerët dhe partnerët e asociuar mund të gjenden në **Seksionin 1.10 - [Applicant Eligibility]** të dokumentit të Thirrjes për Projekt-Propozime.

Q: Cila është mosha minimale për një individ në moshë të re për t'u punësuar në një organizatë?

A: Kontratat e punës së personelit që do të angazhohen në zbatimin e projekt-propozimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar të punës.

Q: Cilat janë kërkesat specifike të stafit? Për shembull, organizata jonë bashkëpunon me shumë individë, por ata nuk janë pjesë e stafit.

A: Personeli i projektit pritet të ofrojë mbështetje të vazhdueshme, të plotë ose të pjesshme, për menaxhimin dhe koordinimin e detyrave administrative dhe financiare të projektit. Kërkesat e tjera për angazhimin kontraktual të personelit dhe ekspertëve të përfshirë në ekipin e projektit janë detajuar në **Seksionin 2.4 [Proposed Project Team]** të dokumentit të Thirrjes për Projekt-Propozime.





Q: Në rast se një projekt-propozim nuk parashikon bashkëpunim me institucionet publike, si bashkitë, a do të penalizohet propozimi gjatë vlerësimit?

A: Bashkëpunimi me institucionet publike nuk është kriter i pranueshmërisë. Megjithatë, është shumë e dëshirueshme dhe, si e tillë, mund të çmohet dhe vlerësohet në përputhje me kriteret e vlerësimit.

Q: A mundet që një pjesë e stafit (që mund të angazhohet me kohë të pjesshme) ose një ekspert të jetë gjithashtu pjesë e një projekti tjetër të zbatuar në një bashki tjetër në kuadër të kësaj Thirrjeje?

A: Neni 3: Konflikti i Interesit të *Dokumentit të Udhëzimeve për Aplikantët*, si dhe **Seksioni 9 i Shtojcës A - [Proposal]** tregojnë qartësisht se ekipi i projektit duhet të jetë ekskluzivisht i disponueshëm vetëm në një projekt-propozim.

